


TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE
DHE NDËRMARRJET

2019



TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE
DHE NDËRMARRJET

2019

**TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE DHE
NDËRMARRJET 2019**

Drejt看 botimi: **Delina Ibrahimaj**

© Copyright INSTAT 2019

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Parathënie dhe Mirënjohje

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), hartoi një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi tregtinë e jashtme të mallrave dhe tregtinë e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjes. Duke iu referuar periudhës nga viti 2014-2018, statistikën në lidhje me tregtinë e mallrave synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e tregtisë së vendit tonë me botën.

Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish.

Materiali pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi tregtinë e mallrave dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare.

Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar falë bashkëpunimit dhe të dhënave administrative të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore që do të shërbenin për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik, në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat e së ardhmes.

INSTAT gjithmonë do të ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim.

Delina IBRAHIMAJ,

PHD Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT

HYRJE	5
GJETJET KRYESORE	6
I. KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE	7
A. Tregtia e jashtme e mallrave.....	7
B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve.....	7
C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore.....	9
D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë.....	9
II. TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2014-2018	10
A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes.....	10
B. Sektorët mbizotërues në eksportet/importet e mallrave.....	11
C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve.....	12
D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese.....	12
E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere.....	13
ANEKSI 1	14
METODOLOGJI	15

Hyrje

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Gjithashtu ndihmojnë kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi eksportet/importet e mallrave në Shqipëri, si edhe statistika të tregtisë së mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve përmbajnë informacion thelbësor mbi ndërmarrjet, të cilat marrin pjesë në tregun ndërkombëtar, si dhe karakteristikat e tyre, vlerat e eksporte/importeve dhe numrin e ndërmarrjeve. Nëpërmjet lidhjes së statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave me statistikat e ndërmarrjeve, kuptojmë kontributin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë si dhe pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla, të mesme dhe të mëdha në transaksionet tregtare. Hartimi i statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, kryhet përmes lidhjes në nivel individual të të dhënave të tregtisë së mallrave me regjistrin statistikor të ndërmarrjeve. Karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve nga regjistri statistikor i ndërmarrjeve – si aktiviteti ekonomik dhe numri i të punësuarve – janë të kombinuar me variablat tipikë të të dhënave të tregtisë së mallrave, si kodi i produktit dhe vendi partner, duke na dhënë në këtë mënyrë një pamje më të plotë të strukturës së tregtisë së mallrave.

Duke iu referuar periudhës 2014-2018, statistikat në lidhje me tregtinë e mallrave në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e tregtisë së vendit tonë me botën.

Ky material, i përgatitur nga INSTAT, publikohet i strukturuar në këtë mënyrë, duke përfshirë të dhënat për vitet referencë 2014-2018 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga dy kapituj. Kapitull i parë paraqet informacion mbi shkëmbimin e mallrave ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera të botës.

Kapitull i dytë ka për objektiv të paraqesë statistika mbi tregtinë e jashtme të mallrave, të detajuar sipas kategorive të ndryshme të ndërmarrjeve.

Gjetjet kryesore

Në vitin 2018 eksportet e mallrave janë 310 miliard lekë, duke u rritur 13,7 % krahasuar me vitin 2017. Ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 641 miliard lekë, duke u rritur 2,4 %, krahasuar me vitin 2017.

Në vitin 2018, pesha e eksporteve në vendet e BE-së është 76 % të eksporteve të mallrave, duke arritur vlerën 237 miliard lekë. Eksportet në vendet e BE-së u rritën me 12,5 %, krahasuar me vitin 2017, ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE-së është 61 % të importeve të mallrave, duke arritur vlerën 391 miliard lekë. Importet nga këto vende u rritën me 1,3 %, krahasuar me vitin 2017.

Në vitin 2018 partneri ynë kryesor për eksportet dhe importet vazhdon të jetë Italia. Vlera e eksporteve drejt Italisë është 149 miliard lekë, duke u rritur 2,1 % krahasuar me vitin 2017, ndërsa vlera e importeve nga Italia 175 miliard lekë, duke u ulur 2,2 %, krahasuar me vitin 2017.

Numri i ndërmarrjeve eksportuese në vitin 2018 është 3.039, duke u rritur me 2,6 %, krahasuar me vitin 2017. Ndërsa numri i ndërmarrjeve importuese është 11.306 ndërmarrje, duke u rritur me 5,6 %, krahasuar me vitin 2017.

Në vitin 2018, ndërmarrjet që operojnë në industri dominojnë ndërmarrjet eksportuese. Këto ndërmarrje kryejnë 83 % të vlerës së eksporteve, duke u rritur me 15,9 %, krahasuar me vitin 2017. Ndërmarrjet që operojnë në tregti dominojnë ndërmarrjet importuese në vitin 2018. Këto ndërmarrje kryejnë 56 % të vlerës së importeve, duke u rritur me 4,2 %, krahasuar me 2017.

Për vitin 2018, më shumë se gjysmën e eksporteve e kryejnë 50 ndërmarrjet më të mëdha (58 %), ndërsa më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 100 ndërmarrjet më të mëdha (56 %).

Në vitin 2018, dominojnë ndërmarrjet që eksportojnë drejt 1 vendi partner. Ato kryejnë 33 %,

të vlerës së eksporteve, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vendeve partnere (23 %).

Në vitin 2018, dominojnë ndërmarrjet që importojnë nga 10 ose më shumë vende partnere. Këto ndërmarrje kryejnë 54 % vlerës së importeve, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 3-5 vende partnere (15 %).

Karakteristikat e tregtisë së jashtme të mallrave

A. Tregia e jashtme e mallrave

Tregtia e jashtme e mallrave

Gjatë vitit 2018 deficitin tregtar është përmirësuar duke u ulur 6,3 %, krahasuar me vitin 2017.

Gjatë periudhës 5-vjeçare (2014-2018) vihet re një tendencë rritjeje e eksporteve dhe importeve (përfshirë ulja në vitin 2015). Në vitin 2018 pesha e eksporteve është 33 %, duke u rritur 13,7 %, krahasuar me vitin 2017. Pesha e importeve në vitin 2018 është 67 %, duke u rritur 2,4 %, krahasuar me vitin 2017.




Fig.1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e jashtme të mallrave

B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve

Produktet kryesore

Produktet që zënë një pjesë të konsiderueshme në eksportet dhe importet shqiptare, për periudhën 5-vjeçare, janë eksportet e mallrave të përpunuara.

Për vitin 2018, më të eksportuara janë grupet e produkteve: "Mallra të përpunuara" me 64 %, duke u rritur me 10,4 %, "Lëndët djegëse" me 13 %, duke u rritur me 72,7 % dhe "Ushqime dhe kafshë të gjalla" me 8 % të eksporteve, duke u rritur me 5,6 %, krahasuar me vitin 2017.



Tab.1 Eksportet sipas Klasifikimit Standard të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4)

milione lekë					
	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	255.759	243.183	243.498	272.988	310.436
Ushqime dhe kafshë të gjalla	11.831	15.599	19.167	24.488	25.867
Pije dhe duhan	1.187	1.031	1.598	1.485	1.793
Materiale të papërpunuara	22.897	22.102	23.289	23.141	18.662
Lëndë djegëse	64.569	45.090	27.397	23.902	41.271
Yndyrna bimore dhe shtazore	91	117	225	243	246
Produkte kimike	2.371	2.872	3.060	3.382	4.523
Mallra të përpunuara	52.409	49.657	44.276	57.828	69.941
Makineri e pajisje transporti	9.203	10.794	11.255	15.118	18.046
Mallra të tjera të përpunuara	90.713	95.751	112.660	123.156	129.836
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	489	169	571	243	250

Grup produktet që dominojnë importin për vitin 2018 janë: “Mallra të përpunuara” me 37 %, duke u ulur me 0,02 %, “Makineri dhe pajisje transporti” me

22 %, duke u rritur me 6,6 % dhe “Ushqime dhe kafshë të gjalla” me 12 %, duke u rritur 0,6 %, krahasuar me vitin 2017.


Tab.2 Importet sipas Klasifikimit Standard të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4)

milione lekë					
	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	552.281	544.616	579.248	626.186	641.466
Ushqime dhe kafshë të gjalla	70.111	72.759	73.616	78.268	78.754
Pije dhe duhan	15.996	16.080	18.343	20.272	20.131
Materiale të papërpunuara	20.680	13.954	12.180	18.926	22.255
Lëndë djegëse	85.538	56.641	46.945	61.711	64.661
Yndyrna bimore dhe shtazore	5.723	5.807	5.562	5.202	4.708
Produkte kimike	63.657	64.471	68.618	74.302	74.858
Mallra të përpunuara	120.169	126.422	144.207	146.820	147.595
Makineri e pajisje transporti	103.089	114.034	126.677	131.630	140.301
Mallra të tjera të përpunuara	67.025	74.268	82.390	88.874	88.045
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	293	180	710	181	159

C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore

Në vitin 2018, pesha e eksporteve në vendet e BE-së është 76 %, duke u rritur me 12,5 %, krahasuar me vitin 2017. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE-së është 61 % të importeve, duke u rritur me 1,3 %, krahasuar me vitin 2017.

Pesha e eksporteve në vendet e CEFTA-s është 16 %, duke u rritur me 21,8 %, krahasuar me vitin 2017. Pesha e importeve nga vendet e CEFTA-s është 7 % të importeve, duke u ulur me 8,7 %, krahasuar me vitin 2017.



	Eksporte	Importe
Vendet e BE-së	76 %	61 %
Vendet e CEFTA-s	16 %	7 %
Vendet e EFTA-s	1 %	2 %
Vendet e tjera	7 %	30 %




Fig.2 Tregtia e mallrave sipas grup-vendeve

D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë

Tendenca e partnerëve tregtarë, 2018

Eksportet në vlerë kanë shënuar rritje të konsiderueshme drejt Italisë, Kosovës dhe Spanjës, ndërsa rritje për importet kanë Greqia, Kina dhe Turqia.

Në vitin 2018 partnerët tanë kryesorë për eksportet janë: Italia (48 %), duke u rritur me 2,1 %, Kosova (9 %), duke u rritur 29,5 %, Spanja (8 %), duke u rritur 61,2 %, krahasuar me vitin 2017.



% krahasuar me 2017

Ndërsa partnerët kryesorë për importet janë: Italia (27 %), duke u ulur 2,2 %, Turqia (8 %), duke u rritur 6,7 %, Kina (8 %), duke u rritur 8,7 %, krahasuar me vitin 2017.



krahasuar me 2017



Tregtia e jashtme e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjes, 2014-2018

A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes

Ndërmarrjet mikro: 1-9 të punësuar,
Ndërmarrjet e vogla: 10-49 të punësuar,
Ndërmarrjet e mesme: 49-250 të punësuar,
Ndërmarrjet e mëdha: + 250 të punësuar.

Në periudhën 2014-2018, numri i ndërmarrjeve eksportuese dhe importuese është rritur. Numri i ndërmarrjeve eksportuese, në vitin 2018, është 3.039, duke u rritur me 2,6 %, krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2018, pesha e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, është 96 %. Pesha për ndërmarrjet mikro është 43 %, ndërmarrjet e vogla është 36 %, ndërmarrjet e mesme është 17 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 4 %.

Në vitin 2018, numri i ndërmarrjeve importuese është 11.306 ndërmarrje, duke u rritur me 5,6 %, krahasuar me vitin 2017. Pesha e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është 98 % e ndërmarrjeve importuese gjithsej. Pesha për ndërmarrjet mikro (1-9 të punësuar) është 65 %, ndërmarrjet e vogla është 25 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej, ndërmarrjet e mesme është 8 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 2 %.




Fig 3 Ndërmarrjet eksportuese dhe importuese

B. Sektorët mbizotërues në eksportet/ importet e mallrave

Industria përfshin:

Industri nxjerrëse; Industri përpunuese; Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar; Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve.

Për periudhën 2014-2018, në ndërmarrjet eksportuese mbizotërojnë, ndërmarrjet që operojnë në sektorin e industrisë. Në vitin 2018, pesha e eksporteve të kryera nga ndërmarrjet që operojnë në industri është 83 %, duke u rritur me 15,9 %, krahasuar me vitin 2017. Ndërmarrjet e mëdha zënë 48 % të vlerës së eksporteve të këtyre ndërmarrjeve, duke u rritur me 26,7 %, krahasuar me vitin 2017.

Për periudhën 2014-2018, vlerën më të madhe të importeve e kanë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e tregtisë. Në vitin 2018, pesha e këtyre ndërmarrjeve është 56 %, duke u rritur me 4,2 %, krahasuar me 2017. Në vitin 2018, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme zënë 91 % të vlerës së importeve të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e tregtisë, duke u rritur me 1,7 %, krahasuar me vitin 2017.




Fig 4 Ndërmarrjet eksportuese dhe importuese



C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve

“Produktet nga përpunimi”, në periudhën 2014-2018 zënë pjesën më të madhe të produkteve të eksportuara dhe të importuara. Në vitin 2018, pesha e eksporteve të këtyre produkteve është 80 %, duke u rritur me 9,4 %, krahasuar me vitin 2017. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet e përpunimit të lëkurës” dhe

“Produktet e veshjeve” (25 %), si edhe “Produktet e metaleve bazë” (15 %). Ndërsa Pesha e importeve të produkteve nga përpunimi është 90 %, duke u rritur me 3,4 %, krahasuar me vitin 2017. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet ushqimore” (11 %) dhe “Koks dhe nënprodukte të naftës të rafinuara” (9 %).




Fig.5 Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve, 2017

D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese

Në periudhën 2014-2017, më shumë se gjysma e eksporteve ishte e përqëndruar në 50 ndërmarrjet më të mëdha. Edhe për vitin 2018, më shumë se gjysmën e eksporteve e kryejnë 50 ndërmarrjet më të mëdha (58 %). Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 56 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 65 %.

Në periudhën 2014-2017, më shumë se gjysma e importeve ishte e përqëndruar në 100 ndërmarrjet më të mëdha. Edhe për vitin 2018, më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 100 ndërmarrjet më të mëdha (56 %). Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 62 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 51 %.




Fig.6 Tregtia e mallrave sipas ndërmarrjeve kryesore, 2018

E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere

Në periudhën 2014-2018, pjesën më të madhe të eksporteve, ndërmarrjet e kryejnë vetëm me 1 vend partner. Në vitin 2018, pesha e eksporteve të këtyre ndërmarrjeve është 33 %, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 3-5 vendeve partnere (23 %). Ndërsa pjesën më të madhe të importeve, në periudhën 2014-2018, ndërmarrjet e kryejnë me më shumë se 10 vende partnere. Në vitin 2018, pesha e importeve të këtyre ndërmarrjeve është 54 %, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 3-5 vende partnere (15 %).





Fig.-7 Tregtia e jashtme e mallrave sipas numrit të vendeve partnere me të cilët kryejnë tregtinë ndërmarrjet, 2018




Aneksi 1:

Metodologji


Burimi i informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është burimi i të dhënave të tregtisë së jashtme të mallrave dhe Burime administrative dhe anketat e INSTAT për Regjistrin e Ndërmarrjeve.



Grumbullimi i të dhënave

Në nivelin konceptual, metodologjia e përdorur në grumbullimin dhe vlefshmërinë e të dhënave mund të shpjegohet sipas skemës në vazhdim:



Përkufizime / Koncepte

Përkufizimet dhe konceptet në këtë shpjegues metodologjik janë dhënë në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë lidhjen ndërmjet përmbajtjes së të dhënave të tregtisë së mallrave dhe regjistrit të ndërmarrjeve.

Ndërmarrja është “kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)”. Marrëdhënia ndërmjet një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: “ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisht ligjore”.

Vendi partner në termat e eksporteve është vendi i destinacionit final të mallrave. Për importet është vendi i origjinës së mallrave.

Vendet anëtare të BE-së – Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Gjermani, Hollandë, Hungari, Irlandë, Itali, Kroaci, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Mbretëri e Bashkuar, Poloni, Portugali, Qipro, Republika Çeke, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi;

Vendet anëtare të CEFTA-s – Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedoni, Moldavia, Serbia, Shqipëria;

Vendet anëtare të EFTA-s – Island, Norvegji, Lihtenshtein, Zvicër.

Eksportet janë vlerësuar me FOB (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin edhe shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit, tek një port i caktuar i ngarkimit). Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë,

të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksporuara pas përpunimit aktiv.

Importet janë vlerësuar me CIF (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin sigurimin dhe transportin, deri tek një port i caktuar destinacion).

Klasifikime

Në përpunimin e informacionit statistikor të tregtisë së jashtme të mallrave mallrave, import-eksportet, është përdorur Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë (SITC), i cili i klasifikon mallrat sipas fazave të tyre të prodhimit. Ndërsa për aktivitetet klasifikimi i aktiviteteve ekonomike NVE rev.2 (emërtimi shkurt në anglisht – NACE Rev.2) dhe për produktet klasifikimi statistikor i produkteve sipas aktiviteteve, NP 2008 (emërtimi shkurt në anglisht - CPA 2008).

